



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1068/1 prot.

Tiranë më 12. 10.2020

Lënda: Mendim mbi draftin e kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1094 Prot., datë 09.09.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim draftin e kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, në vijim gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit").

Nga shqyrtimi i kontratës tip, vërejmë se në nenin 2, parashikohet se kjo kontratë hartohet ndër të tjera, në mbështetje të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar (në vijim "Ligji 9887/2008").

Nga ana tjetër, konstatojmë se të dhënat personale që do të përpunohen nëpërmjet kësaj kontrate janë: emër, mbiemër, numri personal i dokumentit të identifikimit dhe adresa e klientit. Në vijim, në nenin 4 të kontratës tip, parashikohet se këto të dhëna, përhapen nga furnizuesi (në cilësinë e "kontrolluesit" të të dhënave personale), vetëm me pëlqimin e klientit (në cilësinë e "subjektit" të të dhënave personale), në përmbushje të detyrimeve kontraktore, ose në zbatim të një detyrimi ligjor.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit, me qëllim garantimin sa më efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, vlerëson që në kontratën tip, të adresohen edhe disa kërkesa që burojnë nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, sugjerojmë që në tekstin e kontratës, të parashikohet një rregullim sa i përket detyrimit të kontrolluesit për informimin e subjektit të të dhënave personale lidhur me të drejtat që ata gëzojnë, bazuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887/2008.

Gjithashtu, referuar germës d) të pikës 1 të nenit 5, të Ligjit nr. 9887/2008, sugjerojmë që në kontratën tip të parashikohet një rregullim sa i përket “afatit të ruajtjes së të dhënave”, dhe çfarë ndodh me këto të dhëna (fshihen apo shkatërrohen) me mbarimin e qëllimit të përpunimit apo përfundimit të kontratës.

Me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme, drafti i kushteve të përgjithshme të kontratës tip vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

